



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1386/6 Prot.

Tiranë, më 10.09 2026

VENDIM

Nr. 105 datë 10.09 2026

PËR
MIRATIMIN E LËVIZJES PARALELE TË NJË PUNONJËSI, PERSONEL
AKADEMIK NGA INSTITUTI I KËRKIMIT SHKENCOR TË SPORTIT, NË
FAKULTETIN E VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT

Mbështetur në Ligjin nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", në Statutin e UST-së neni 25, pika 3, gërma d), në Udhëzimin e MASR nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL", në Vendimin e Senatit nr.13, datë 30.01.2026 "Për miratimin e strukturës organizative, analitike dhe klasifikimit të pagës për vitin 2026", në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.11, datë 02.02.2026 "Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike, dhe klasifikimit të pagës për vitin 2026", si dhe në Vendimin e Rektoratit, nr. 95, datë 07.07.2026 "Për miratimin e lëvizjes paralele të një punonjësi, personel akademik nga Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit, në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit", Senati në mbledhjen e radhës,

VENDOSI:

1. Miratimin e lëvizjes paralele të **Prof. Dr. Agron Kasa**, personel akademik në Departamentin e Projekteve dhe Teknologjisë, Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit, kalon në Departamentin e Menaxhimit të Sportit dhe Turizmit, Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit.
2. Kjo lëvizje paralele nuk sjell efekte financiare apo ndryshime në ngarkesën mësimore, të planifikuar sipas marrëveshjes për organizimin e kohës vjetore të punës për personelin akademik në IAL.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Dekanati i FVFR, Drejtori i IKSHS, Departamentet e njësive kryesore, si dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. **Agron KASA**

